



Nr. I-65
Br.

Data 20.04.2018
Datum

OBILIQ OBILIC



Republika e Kosovës - Republika Kosovo - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Kuvendi Komunal Obiliq - Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obiliq

Në mbështetje të nenit 43 dhe 47 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040 dhe nenit 47, Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr.02/2015, për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës, nenit 48.3 te Statutit të Komunës si dhe nenit 3.9 të Rregullores së punës së Kuvendit thërras:

Mbledhjen e Kuvendit të Komunës (Legislatura e VI, mbledhja e 7) me dt.30.04.2018 (e hënë) në ora 10:00, në sallën e Kuvendit komunal me këtë:

REND DITE

1. Arsyetimi për mungesë
2. Aprovimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar
3. Shqyrtimi i Draft Rregullores për Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoba Komunale
4. Shqyrtimi i Planit të punës së Kuvendit komunal për vitin 2018
5. Raporti finansiar 3 mujor i DFEZH
6. Të ndryshme

Kryesuesi i Kuvendit Komunal

Burim * Gërguri



Dalës Izazna

Nr. 1-41
Br.

Data 30.03.2018
Datum

E K S T R A K T I P R O C E S V E R B A L I T

Nga mbledhja e Kuvendit komunal, të mbajtur me dt.30.03.2018, në orën 10:00, në sallën e Kuvendit komunal.

Të pranishëm janë këta këshilltarë: Burim Gërguri, Labinot Mirena, Enver Gashi, Florije Jashari, Agon Mjekiqi, Qëndresa Dubova, Shaip Paloja, Fatos Kurshumlija, Fatmir Bekteshi, Linda Sadiku, Arbnore Nasufi, Hysni Mjeku, Lulzim Sadiku, Samire Berisha, Aziz Bici, Xhezide Dragusha, Armend Rushiti, Nora Preniqi, Dragan Dancevic, Nazmi Gashi dhe Slavisa Spasic

Të pranishmit tjerë: Xhafer Gashi, Kryetar i Komunës, Ajet Berisha, Nënkyetar i Komunës, Përparim Klinaku, drejtës i adm. së përgjithshme, Naim Miftari, drejtës i DSHPE-së, Fitore Hashani, drejtëreshë e DKRS-së, Fatmir Bërbatovci, drejtës i DPUKP-së, Ibush Mjekiqi, drejtës i DSHMS-së, Ferid Hashani, drejtës i bujqësisë, Agim Spahiu, drejtës i DKA-së, Arben Berisha, drejtës i DMM-së, Zarife Behluli, drejtëreshë e DFEZH, Fatime Pllana, shefe për Arsim fillor, përf. e OSBE-së, përf. e KFOR-it dhe qytetarët e Hades

Mbledhjen e udhëhoqi Burim Gërguri, kryesues i Kuvendit komunal i cili pasi konstatoi se ka kuorum filloj mbledhjen me këtë:

R E N D D I T E

1. Arsyetimi për mungesë
2. Aprovimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar
3. Rekomandimet e KPF-së, të dt.28.03.2018
4. Shqyrtimi i Draft Rregullores për ndarjen e bursave dhe kompenzin e shpenzimeve të udhëtimit
5. Shqyrtimi i Propozimit i Drejtorisë komunale të Arsimit (DAK)-ut, për pagesën e ish punëtorëve të Arsimit (sipas kontratës kolektive)
6. Shqyrtimi i kërkesës për iniciimin e procedurës për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores së punës së Kuvendit komunal
7. Formimi i grupit për hartimin e Planit të punës së Kuvendit komunal
8. Shqyrtimi i Raportit finansiar i Kryetarit të Komunës për vitin 2017
9. Shqyrtimi i kërkesës për iniciimin e procedurës për hartimin e Draft Rregullores për shfrytëzimin e veturave zyrtare
10. Shqyrtimi i kërkesave
11. Të ndryshme

Burim Gërguri – ju njoftoj se na ka ardhë një Peticion nga banorët e fshatit Hade, me 300 nënshkrime dhe kërkesa e tyre është që për arsyet e afatit kohor të trajtohet si pikë e rendit të ditës.

Enver Gashi – ne e dijmë problematikën e Hades dhe të Shipitullës, të pjesës ku vepron KEK-u, dhe ne si grup parlamentar i AAK-së, mendojmë se duhet të hyj në rend dite, të trajtohet taman ashtu qysh na ka hije sepse ne po punojmë për njerëzit tonë, që mos të mbeten anash dhe ne të japim kontributin tonë aq sa kemi mundësi.

Shaip Paloja – mendoj se çështja e Hades është një çështje shumë me rëndësi dhe e ndijshme sepse po të shkojmë në atë fshat është tmerr dhe një katastrofë e vërtetë. Ky Kuvend është marrë disa herë me çështjen e Hades, por sipas të gjitha gjasave nuk është marrë aq seriozisht sa ata meritojnë. Atyre, gjithmonë ju ka premtue, mirëpo nuk është bërë asgjë për ata. Peticioni i ardhur në këtë seancë, mendoj se është pak me vonesë sepse ata nuk e meritojnë me u marrë aq në shpejtësi çështja e tyre, por duhet të merret pak më seriozisht dhe Komuna, ka obligime të mëdha ndaj tyre. Unë nuk jam kundër asaj që ai

peticion të shqyrtohet sot, por mendoj se aty duhet të nxjerren vendime shumë më me rëndësi se një rekomandim.

Lulzim Sadiku – edhe ne si grup parlamentar pajtohem i që kjo pikë të hyj në rend dite.

Armend Rushiti – edhe ne jemi për atë që kjo pikë të hyj në rend dite edhe pse nuk po e dijmë saktësish se për çka është fjala dhe sa kemi ne mundësi me pasë kompetenca për këtë çështje.

Aziz Bici – më vjen keq që materiali nuk na është dorëzuar me kohë që ne me mund me dhënë kontribut shumë më të madh sepse çështja e Hades, deri më sot është dashur shumë moti të kryhet, por ne jemi mësuar kështu me na sjellë materialin me vonesë. Poashtu, me vonesë na është sjellë materiali në mënyrë elektronike. Meqenëse, ju e konstatoni se kjo pikë e rendit të ditës është shumë e rëndësishme, atëherë ne e përkrahim.

Burim Gërguri – kërkoj falje se Peticioni ka ardhë dje dhe s'kemi mund me ua dërgue edhe juve. Tani, propozoj që Peticioni të shqyrtohet në pikën e 3 të rendit të ditës.

Pas diskutimeve, këshilltarët komunal unanimisht e miratuan rendin e ditës me ndryshimin që pika e 3 te jetë: "Shqyrtimi i Petacionit të banorëve të fshatit Hade".

Shaip Paloja – te rendi i ditës, pika 3 "Rekomandimet e KPF-së" të dt.28.03.2018, nuk e di qysh mund të jetë kur ne materialin e kemi marrë me 21 mars dhe paraprakisht me dt.21, e keni ditë se cilat janë rekomandimet që kanë me u mbajtë me dt.28, që po bjen në kundërshtim me vetveten.

Burim Gërguri – sqaron se kjo çështje është procedurë dhe pse është mbajtë KPF-ja, afër me Kuvendin është arsyaja derisa ka ardhë ligjshmëria e Komiteteve dhe ne menjëherë pas mbledhjes së KPF-së, me dt.28, i kemi përpiluar rekomandimet të cilat ua kemi dërguar të gjithëve.

Tani, kryesuesi lexon Petpcionin e nënshkruar nga banorët e fshatit Hade, për përfshirjen e fshatit, pjesa qëndrore në procesin e zhvendosjes, me rastin e zhvillimit të minjerës së re të thëngjillit.

Ragip Grajqevci, përf.i fshatit Hade – ju falenderoj shumë për përkrahjen tuaj unanimisht për këtë pikë të rendit të ditës. KEK-u, na ka përkrahë për herë të parë në këtë projekt madhor, por kërkojmë nga Komuna, që të nxjerr një vendim, e jo rekomandime, që të na përkrahë dhe të revidon vendimin e mëhershëm. Kërkesa jonë është që të mos anashkalohet pjesa e Hades, qendër.

Burim Gërguri – Kuvendi komunal, do të veproj në bazë të fuqisë ligjore dhe mandatit që e ka marrë dhe besoj se maksimalisht edhe Kuvendi dhe Kryetari i Komunës, cdoherë kemi qenë në përkrahjen legjitime të kérkesave të banorëve të fshatit Hade.

Kryetari – është e vërtetë, se tani është duke u projektue projekt i ri për minjerën e re dhe në këtë rast ne kemi informacione, që nga viti i kaluar rrëth zhvillimeve që po ndodhin atje dhe rrëth 120 hektarëve. Kërkesë e jona, që është edhe vetë kérkesë e KEK-ut, është që të përfshihet në këtë rast edhe Hadja, sepse do të jetë një strategji 50 vjeçare. Nëse, në këtë rast nuk përfshihet fshati Hade, atëherë ajo do të mbetet për 50 vitet e ardhshme, ashtu si është. Atje, pamundësohet jeta për shumë arsy që ne i dijmë dhe që i atakojnë çdo ditë qytetarët në atë zonë, duke filluar nga zhurma, pasiguria, infrastruktura etj. Sipas njoftimit nga ministri i zhvillimit ekonomik brenda 10 dite, do të jetë propozimi edhe në mbledhje të Qeverisë. Sa i përket çështjes së zhvendosjes, planifikimit të minjerës së re, besoj se në këtë drejtim do të përdoren të gjitha mundësitë, në këtë rast edhe të Kuvendit dhe të Ekzekutivit dhe mundësive tjera, që do ti shfrytëzojmë nëpër institucione të nivelit qëndror, me qëllim që të përfshihet si pjesë e kësaj strategjie 50 vjeçare, edhe fshati Hade. Tani, veç e kemi një zotim të mjeteve fillestare për projektin 1 milion e 950,000 €, që e kemi fitue si projekt të ri nga Ministria e infrastrukturës dhe ne mund të fillojmë në rregullimin e infrastrukturës në atë zonë.

Enver Gashi – është shumë interesantë puna e minjerës të Mirashit, ose e KEK-ut. Ajo shtrihet prej minjerës që i kanë thënë maden deri në Shipitullë dhe tash janë disa ide se duhet me u sjellë nga Sibofci e me dalë andej dhe Zhilivodë, që edhe kushton. Një element tjetër me rëndësi është se kjo pjesë ku është zbulue minjera, aty edhe vetëdigjet thëngjilli dhe përvëç që na shkon thëngjilli dëm, ajo edhe ndotë ambientin. Një propozim tjetër është se do të shkon edhe nga Lismiri atje, dhe është fronti i hapur prej,

madenit deri në Shipitullë, që ka rezerva jo për 50, por edhe për 100 vjet, duke përfshirë edhe Haden deri në rrujanë që shkon për Shipitullë dhe Grabofc. Mendoj se gjyqji duhet të merret me ata njerëz që mundohen të bëjnë kësos krimesh në ekonomi dhe pasuri të shtetit. Më vjen mirë që e keni marrë këtë iniciativë dhe do të më keni gjithë në përkrahje me laps, me letër dhe me fakte, e jo me teori boshe.

Shaip Paloja – dihet se strategjinë e mihiave sipërfaqësore nuk e bën Komuna jonë, por e bën Ministria e zhvillimit ekonomik dhe fatkeqësisht ne gjithmonë jemi viktivë e këtyre zhvillimeve ekonomike dhe e një interes nacional, që ne gjithmonë shkëlemi. Unë nuk di a ka më interes nacional se vetëjeta e njerëzve dhe faktikisht te ne llogaritet që është interes, por njerëzit nuk llogariten. Unë sa kam informata, strategjia e zhvillimit të mihiave është deri në vitin 2067, kur ke parasysh se duhet të plotësohen edhe kriteret e BE-së, për energji të ripërtijshme ose energji t'ë renovueshme. Ne Hades, gjithmonë do ti dalim në ndihmë dhe e kemi për obligim, por duhet të kemi kujdes në nxjerrjen e vendimeve sepse ato vendime duhet të janë të ekzekutueshme. Mendoj se duhet të formohet një Komision, që këtyre banorëve t'ju jepen këshilla juridike nëse, është nevoja edhe financiarisht t'ju ndihmohet, ndoshta të angazhohen edhe avokatë ndërkombetar. Pérndryshe, ku janë këta banorë dhe ku është zona e fshatit Hade, aty nuk ka jetë, me asnje kriter, me asnje ligj ndërkombetar nuk besoj se ka mundësi që më të jetohet aty. Zhvillimi i mihiave vazhdon mëtutje nga Sibofci, mihi është në Hade, që fatkeqësisht i thuhet Sibofci jugperëndimor, që është një fatkeqësi dhe pse thuhet ashtu, nuk e di. Mihi tjetër që u përmendë te Lismiri, mendoj se aty ka filluar fatkeqësia për fshatin Hade sepse aty janë me hektarë të paguar, të licencuar për nxjerrjen e qymyrit dhe pse ka fillue paslufte mihi e re pa planifikim, apo dikush e ka planifikue për interesa të veta personale, unë atë nuk e di. Mendoj se ne këtyre banorëve patjetër duhet t'ju dalim në ndihmë, ndoshta edhe financiarisht t'ju ndihmojmë dhe të jemi gjithmonë pranë tyre.

Lulzim Sadiku – pajtohem i që në çdo mënyrë t'ju ndihmojmë, me çdo vendim që kemi mundësi ligjore, të jemi pranë fshatit Hade. Unë kisha dashur nga Kryetari të kemi ekspertë të cilët merren me këtë profil. Ne po flasim se kemi të dhëna, por unë nuk kam as vendim me shkrim se nga shkon mihi. Mirëpo, e di se fshati Hade, është në situatën më të rëndë të mundshme dhe grapi parlamentar i PDK-së, është gjithmonë për me i ndihmues Hades, përkrahje kudo që është e nevojshme. Kërkoj të formohet një grup punues nga Kuvendi, që ka nevojë me i ndihmues fshatit Hade. Pra, jemi pro çdo kërkese të fshatit Hade.

Nazmi Gashi – unë jam në rrjedhat e administratës kaherë, i di problemet e këtyre qytetarëve dhe përkrahja është normal pa rezervë, por ky është problem administrativ prej vitit 2004-2011 me vendimin e Qeverisë. Pastaj është vazhdue edhe tani dhe këto vendime po zbatohen pjesërisht dhe qytetari po shkodën dëm. Kjo që po i ndodh Hades, e di se shumë shpejt ka me i ndodhë edhe Sibofcit dhe ne i kemi të njejtat brenga. Besoj se Kryetari e ka dhënë kontributin e vet, Komuna e ka dhënë në mënyrë administrative edhe më heret kontributin e vet dhe tani është koha mos me bë lëshim, të merremi sinqerisht me këtë çështje sepse nuk kemi afat dhe nuk kemi zgjidhje tjetër. Besoj se me një autorizim të plotë të Kryetarit dhe sistemit administrativ të Komunës, ne duhet me dhënë ndihmën dhe përkrahjen maksimale për qytetarët tonë.

Aziz Bici – ne grapi i LVV-së, kemi qenë dhe vazhdojmë të jemi në përkrahje të vazhdueshme për banorët e Hades, edhe pse ne e kemi konstatuar që moti se janë bërë padrejtësi të banorëve të Hades. Tani, në shikim të parë kur shihet gatishmëria, duket sikur ne do t'ua zgjidhim të gjitha problemet që i kanë. Mirëpo, unë që nga ky moment shprehu gatishmërinë time që t'ju jem afër për çfarëdo përkrahje të tyre, që ata do të kenë rrëth zgjidhjes së çështjeve të tyre. Poashtu, edhe unë kërkoj nga Kryetari që të ndahen mjete, që juridikisht çfarëdo që do të ketë nevojë t'ju ndihmohet atyre në zgjidhjen e çështjeve të tyre. Kërkoj që kërkesa e paraqitur nga banorët e Hades, të fotokopjohet gjatë kësaj senace, të na shpërndahet, në mënyrë që ne të dijmë se çka po diskutojmë, çka po dojmë dhe të kemi informacionin e duhur.

Hysni Mjeku – vetë dërgimi i Peticionit, lenë me kuptue se është çështje tepër serioze dhe problemi i Hades, është një plagë që rrjedh gjak, të cilën vërtetë nuk po mundemi me shërue dhe për ta shërue këtë plagë, ne duhet të marrim veprime konkrete. Besoj se Drejtoria përkatëse dhe ky Kuvend duhet të formoj një plan të veprimit urgjentë dhe të ndërmerren masat kohore sepse thotë një fjalë latine: “Fjalët i merrë

era, ndërsa shenimet mbeten". Për të mbetë shenimet dhe për ti realizuar këto veprime, ne duhet të ndërmarrim masa urgjente dhe jo vetëm interesin nacional, por duhet të shikohet edhe interesin lokal sepse këta banorë vërtetë janë në gjendje të mjerueshme. KEK-u, kudo që do të shtrihet, ne për këta banorë duhet të ndërmarrim veprime, po them sinqerisht se afatet janë të shkurtëra, ndërsa pasojat mund të jenë shumë të mëdha. Bazuar në faktin se aty më nuk ka as infrastrukturë të një jete normale, aty më nuk ka as rregullë shtëpiake, e le më jetë normale, prandaj siç kemi vepruar në vitin 2005, me pjesën e lagjes së Shalajve, ne duhet të jemi aq këmbëngulës kësaj radhe me pjesën e mbetur më se 70 %, të fshatit Hade që ka mbetë si një oazë, e cila vërtetë është e dhimbshme. Këta banorë, jo që nuk dijnë nga të shkojnë, por ju kemi pamundësue edhe jetën më minimale. Kujtoj se ne në bashkëpunim me Kryetarin, nëse jemi këmbëngulës që kërkesat tona vërtetë ti jetësojmë, besoj se problemi i fshatit Hade duhet të zgjidhet njëherë e përgjithmonë. Unë nuk dëshiroj të kemi skena sikur me veprimin e lagjes Hade, policia që ka ndërmarrë sepse këta banorë të gjithë po pajtohen që të gjejnë një zgjidhje sa më fatlume, e jo të demonstrojnë dhunë. Edhe atëherë, unë kam qenë pjesë e Kuvendit dhe kam gjykue veprimin e policisë së Kosovës, të ndërmarrë ndaj banorëve të pjesës së Shalajve. Prandaj, edhe kësaj radhe dëshiroj që me bashkëpunimin tonë edhe të fshatarëve të kësaj pjese, ta gjejmë rrugën, ta zgjidhim problemin dhe të mos kemi skena të tillë. Unë po them sinqerisht se aty 24 orë, nuk duhet të mbeten banorët dhe nuk duhet të vazhdohet jeta. Unë kam dëgjue se po bëhen planifikime për zhvillim të jetës, por kujtoj se derisa të jetohet ne duhet të investojmë aty dhe më mirë të investojmë në drejtim të zgjidhjes së problemit njëherë e përgjithmonë të kësaj pjese. Është interes i këtij Kuvendi, që t'ju dalim në mbrojtje këtyre fshatarëve sepse Qeveria e ka rrezikue, e ka dëmtuar rrënjisht këtë pjesë dhe atyre ju është prish jeta normale. Ne nuk guxojmë të kalojmë sikur te këta nuk ka ndodhë asgjë dhe është e rëndësishme që ne këtij problemi ti qasemi seriozisht dhe ta zgjidhim problemin e këtyre fshatarëve.

Labinot Mirena – unë si përfaqësues i banorëve të Hades, ju falenderoj të gjithëve për përkrahje në kërkesat tona. Unë kërkoj prej juve, që të gjithë së bashku subjektet politike të planifikojmë një protestë, në javën që vjen të mëkurën të na bashkangjiteni prej orës 12-13. Ju bëjë thirrje juve Kryetar, kryesues, partive politike, që të na bashkangjiteni në protestë sepse është mundësia e fundit për fshatin Hade.

Burim Gërguri – fshati Hade, është vetë histori e Obiliqit, për shkak të minjerës dhe jo rastësisht kjo stema pranë Komunës, dmth është zonë industriale falë natyrës që ia ka dhënë këtij territorit, në këtë rast Hades, Dardhishtës e Sibofcit. Problemi i tyre është me vite dhe tash ka ardhë momenti që të zgjidhet ky problem. Unë e di se vullneti i Kryetarit në këto 5 vite, nuk ka mungue dhe do të vazhdoj edhe mëtutje së bashku me përkrahjen e banorëve. Besoj se edhe të mëkurën njerëzit e vullnetit të mirë do të jenë në protestë. Unë kërkoj që jo vetëm Hadja, por edhe plani i zhvendosjes të mihjes së re të përfundon në afatin sa më parë sepse kur ka vullnet politik, ndoshta ka edhe mundësi të zgjidhet problemi.

Aziz Bici – së pari ne e marrim kërkesën e analizojmë dhe sigurisht se do të jemi në përkrahje të banorëve të Hades, nga se kjo nuk është vetëm në interes të banorëve të Hades, por është në interes të gjithë neve, sepse nuk mundemi ne që vazhdimisht të na përcjellin problemet e njejtë. Ne po e marrim gabimisht sepse po kujtojmë se po i bëjmë zgjidhje Hades, por ne po i bëjmë zgjidhje vetes tonë, po e kryejmë një problem me aq vite e dekada. Sa i përket propozimit për protestë unë jam kundër, nga se që në start po bëjmë gabim sepse duhet urgjentë, që ato të drejta dhe obligime që na jepë ligji me startue menjëherë drejtorët e Drejtoreve, të jemi në dispozicion ti shterojmë të gjitha mundësit që neve na i jep ligji, pastaj vijnë metodat tjera.

Shaip Paloja – Kryetari e përmendi se janë ndarë disa mjete financiare, për infrastrukturë dhe tash ne po biejmë në kundërshtim me vetveten sepse nëse investohet në infrastrukturën e Hades, atëherë ku ka logjikë protesta, ku ka logjikë nxjerrja e vendimeve, ose ndoshta nuk e kam kuptue mirë.

Kryetari – ju falenderoj të gjithëve që kontribuat në diskutim dhe jo njëherë, por gjithëherë e kemi thënë se janë disa situata kur ne si qytetarë të Obiliqit, s'do të kemi parti politike dhe në këtë rast e kemi Hadën. Unë do ti bashkohem protestës dhe jo vetëm të mëkurën, por çdo ditë që protestojmë. Ne kemi shumë dëshmi sa i përket çështjes së reagimeve që kemi bërë ndaj KEK-ut, jo vetëm për rastin e minjerës së re,

por edhe për çështjen e punësimit. Ne kemi pas takime të shumta me MPH-në, dhe ju e dini se është nënshkruar një marrëveshje me iniciativën tonë, që e kemi marrë një barrë si Komunë. Sa i përket çështjes së investimit në lagjen e re të Hades, bëhet fjalë në Shkabaj dhe për 3 vite rresht kërkesat në KEK, janë drejtue për çështjen e rrugës së Hades. Ajo definitivisht është zgjidhë në vitin e kaluar që të shtrohet kjo rrugë, por për shkak të keqësimit të motit nuk kanë mund ti realizojnë punimet, që besoj se ata do të vazhdojnë me punime. Mendoj se përveç votimit të Peticionit që është e drejtë ekskluzive e këshilltarëve, kërkoj që të krijohet edhe një Komision i përbashkët që me Ekzekutivin, ti trajtojmë të gjitha kërkesat dhe unë e potencova më heret se di sa e kuptuat se brenda 10 dite, kjo çështje do të jetë në mbledhje të Qeverisë. Nëse, ne nuk mund të ndërhyjmë në aspektin ligjor, është mirë me dalë në mënyrë të civilizuar me përkrahë protestën e qytetarëve, ti lejmë anash partitë dhe të jetë sa më masive, aq me fuqi do të jetë zëri i Hades. Me çështjen e Hades, ne e zgjidhim problemin e Obiliqit sepse të njejtin fat e ka Obiliqi, Dardhishta, Lajthishta, Shipitulla, do ta kenë Hamidia dhe Sibofci e tjerat.

Aziz Bici – nuk është këtu çështje e partive, por këtu është çështje e rezikut për intereset e grupeve sepse brenda kërkesës qysh e pashë unë mund të përfshihet edhe ndërtimi i Termocentralit të ri. Në rast se neve na kanë vendos kushte brenda asaj körkese dhe ka dashtë dikush me i manipulue banorët e Hades, për neve, do të jetë përgjegjësi në të ardhmen sepse jemi me votë. Për mua, është shumë pak me dalë në protesta, se ne krejtë e dijmë me dalë një gjysmë apo një orë dhe në rast se mendoni se banorët e Hades mund të janë të kënaqur, unë nga këtu po ju them se me protesta kurrë asgjë s'kanë fitue dhe s'kanë me fitue, prandaj me këto formalitetë mos të kënaqen. Nganjëherë ne po e qesim qeverinë sikur nuk është e-këtij populli që ne po e votojmë, por pse ata neve me na sjellë para këtij akti, pse neve mos me na dhënë kohë të mjaftueshme, këta ministra ne vetë i votojmë. Prandaj, këtu nuk është çështje e partive, por është çështje e interesave grupore.

Ajet Berisha, Nënkyetar i Komunës – pajtohem me atë që e tha z.Aziz Bici, në kuptimin e aspektit ligjor sepse ne si Komunë, gjithsesi kemi diskutue me Kryetarin që fillimi do të ndjekum rrugën ligjore dhe duhet ti gjejmë mekanizmat që Qeverissë, me i imponue aspektet që të drejtën e qytetarëve me realizue. Mendoj se fillimi duhet të marrim vendimin e vitit 2009, të nxjerrë nga Qeveria për shpalljen zonë me interes të veçantë dhe në bazë të saj ka ndërtue një strategji që planifikon se cilat fshatra do të zhvendosen. Mendoj se duhet të angazhojmë një juristë të mirë që këtë shkelje në raport me Komunën dhe të drejtave të qytetarëve, në bazë të vendimeve që Qeveria vet i ka nxjerrë me mbrojtë juridikisht dhe me imponue në kuadër të strategjisë së re që po planifikon Qeveria e Republikës së Kosovës. Pra, në rast se është kështu atëherë, urgjentisht duhet të formohet një ekipë që kjo mos të na ndodhë, por më shumë duhet ekipë juristësh, që me ditë me mbrojtë këtë të drejtë.

Burim Gërguri – pas këtij debati të frytshëm dolën 2 rekomandime, një të votohet Peticioni dhe kërkesa e banorëve të Hades, dhe 2 të formohet një Komision mikë nga Kuvendi, Këshilli i fshatit i cili do ti kordinonte punët me Kryetarin e Komunës, sa i përket planit afatgjatë në zhvillimet e reja që do të ndodhin.

Hysni Mjeku –ju lutemi, çështja e Hades nuk duhet kaluar aq shpejtë kësisozi dhe unë kam mendue edhe një seancë e veçantë të thirret sepse duhet të nxjerren dokumente. Nëse nuk nxjerren dokumente, atëherë ne kot kemi përkrah Peticionin. Mendoj se duhet të nxjerret një plan i veprimit urgjent dhe nëse, këtë nuk e bëjmë, atëherë ne faktikisht nuk kemi bërë asgjë. Prandaj, kërkoj nga ky Kuvend të marrim vendime të rëndësisme, jetike dhe të afatizuara se deri ku mund të shkoj kjo çështje, e jo në infinit.

Burim Gërguri – sqaron se rekomandimi kur erdhi ishin 2 kërkesa, që Komisioni të jetë mikë i cili do ta bëjë një plan të veprimit bashkarisht Kuvendi, Ekzekutivi dhe banorët dhe do të kishim raport në seancat e radhës. Ne kemi debatue dje me banorët e Hades dhe ata kanë kërkuar që çështja në fjalë të trajtohet sot për arsyet e afatit 10 ditor, sepse Hadja ndoshta ka kërkue me trajtue edhe në një seancë të jashtëzakonshme, por për shkak të afatit nuk kemi pasë mundësi.

Kryetari – sa i përket vendimit është mirë të formohet një Komision i përbashkët ashtu qysh e potencuam më heret nga Ekzekutivi, Kuvendi dhe nga banorët e Hades. Ky Komision duhet ti drejtohet

me një shkresë urgjente Kryeministrat, ministrit të zhvillimit ekonomik, Bordit të KEK-ut dhe Ekzekutivit të KEK-ut, me qëllim që ky Komision të jetë pjesë përbërëse e grupit punues të strategjive të reja në Obiliq, në këtë rast për Minjerën e re dhe Termocentralin. Pastaj, ky Komision mund të nxjerr nga arkiva të gjithë dokumentacion që nga paslufta, ti trajton të gjitha kërkesat që nga paslufta të cilat janë realizue apo nuk janë realizue kurrë. Poashtu, ky Komision duhet të jetë i përgatitur në aspektin profesional siç e tha edhe Nënkyetari, të ketë ndonjë jurist në grup, apo nëse ka nevojë të merret ndonjë jurist i jashtëm. Mendoj se pas nxjerrjes së vendimit ne do ti drejtohami me shkresa niveliit qëndror dhe operatorit ekonomik.

Ajet Berisha, Nënkyetar i Komunës – Kuvendi nuk është kompetent me nxjerrë vendim në emër të Peticionit, apo të një kërkesë, por ne jemi sugjerues në Qeveri ose në cilindo institucion që është përgjegjës dhe mund të bëjmë presion që me u zbatue vendimet e mëhershme të tyre. Ne rekomandojmë që ky Peticion të merret parasysh duke mos mendue vetëm në qendrën e Hades, por në férësi sipas vendimit të vitit 2004, 2009 të Qeverisë dhe zbatimin e strategjive të përpiluara më heret nga vet Qeveria.

Burim Gërguri – lexon vendimin e Kuvendit komunal të vitit 2006, përmes mbështetjen e kërkesave të Hades, përmes zhvendosjen e tyre sipas marrëveshjes në mes të qytetarëve të Hades dhe MPH-së.

Lulzim Sadiku – a është më mirë të nxjerrim vendim apo rekomandim kryesues, duhet të bisedohet me përfaqësuesit përmes çështje juridike dhe ta rregullojmë këtë çështje.

Hysni Mjeku – ne jemi insitucion dhe duhet të marrim vendime, e jo rekomandime, vendim decidiv që pjesa e mbetur e Hades të dislokohet urgjentisht sepse banorëve të Hades, ju është prish substanca jetësore, ju është sjellë miha te shkallët e shtëpisë.

Aziz Bici – çështja është se kujt ne po ia japim atë obligim prej drejtoreve të Drejtorisë, apo prej një Komisioni, që në bazë të atij vendimi me punue. Në vendim duhet të përfshihet se kush do të jetë i obliguar që me i shtye çështjet përpara.

Pas diskutimeve, këshilltarët komunal unanimisht morën këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Peticioni i banorëve të fshatit Hade – zonë me interes të veçantë ekonomik “Fusha e Mihjes së Re” MMPH/2011.
2. Kërkohet nga Qeveria e Republikës së Kosovës, të merrë në konsideratë Peticionin e banorëve të fshatit Hade, përmes zhvendosjen e fshatit.
3. Qeveria, Ministritë përgjegjëse dhe KEK-ut, të marrin përmes obligim që Vendimin e marrë nga ana e KEK-ut, përmes orientimit – drejtimin e Minjerës së Re të përfshin komplekt fshatin Hade në Planin përmes zhvendosje.

Kryetari – së pari ne diskutuam që të formohet një Komision dhe nëse, Komisioni formohet prej Ekzekutivit dhe Kuvendit, duhet të bashkangjitet edhe një përfaqësues i Hades. Poashtu, është më mirë të përcaktohet numri i anëtarëve të Komisionit, i cili nuk duhet të jetë numër i madh sepse edhe mundësia e grupimit është problem. Ju lus të propozohen njerëzit të cilët mund të jalin kontribut në këtë drejtim.

Pas diskutimeve, këshilltarët komunal unanimisht morën këtë:

V E N D I M

Formohet Komisioni komunal përmes shqyrtimin e kërkesave të banorëve të fshatit Hade, me rastin e zhvendosjes së pjesës së mbetur me këtë përbërje:

1. Xhafer Gashi, Kryetar i Komunës
2. Arben Berisha, (DMM)
3. Fatmir Bekteshi (LDK)
4. Hysni Mjeku (PDK)
5. Labinot Mirena (AAK)
6. Ragip Grajqevci, përf. i Hades
7. Aziz Bici (LVV)

I.Pika e parë e rendit të ditës – Prezentë janë të gjithë këshilltarët komunal.

II.Pika e dytë e rendit të ditës –

Shaip Paloja – kam vërejtje në procesverbalin nga mbledhja e kaluar sepse pasi opozita e ka lëshuar mbledhjen, unë në procesverbal nuk e pashë se është konstatue kuorumi. Pastaj, te votimi i KPF-së, është bërë një gabim sepse thuhet 11 vota “Për” 10 vota “Kundër” dhe 1 “Abstenim” kur dihet se Kuvendi i ka 21 anëtar, e jo 22. Poashtu, te formimi i Komitetit për komunitete, ju e keni dhënë një emër që aty është paraparë të jetë nga gjinia femërre, ndërsa aty figuron emri Nazmi Gashi, që ka qenë rezervuar për LDK-në. Paraprakisht në KPF, unë e kam dhënë emrin e Fatos Kurshumliut dhe ju i nderuar kryesues, keni thënë se çështja e emrave ka përfunduar. Tani, në Komitetin për komunitete, nuk e kemi asnjë anëtar, kryesues e din mirë se çka thotë ligji. Është bërë edhe një shkelje se kur është formuar KPF-ja, ju e dini se Nazmi Gashi, ka kalue në grupin parlamentar të LB-së, dhe tash po delë se në atë Komitet janë një, anëtar i LB-së dhe një nga Nisma. Tani, ne duhet të dijmë se këta a janë bashkë, apo janë ndarë.

Burim Gërguri – përgjegjen do ta japë në pikën “Të ndryshme” sepse nuk ke qenë prezentë dhe anëtarë nga AAK-ja, ka dhënë dorëheqje për arsyet e kuotës së gjinisë femërore dhe tash s’kemi kohë për këtë çështje. Ne monitorohemi nga MAPL-ja, dhe pa kuorum s’mund të vazhdojmë mbledhjen.

Shaip Paloja – unë nuk kam qenë në seancë, por procesverbalin e kam para vetes dhe ne pasi jemi këtu, mund ta vazhdojmë këtë debat edhe më vonë, por ndoshta nuk ishte mirë me fillue pasi s’keni kohë.

Burim Gërguri – ju lus që çdoherë kur diskutoni afrohuni te mikrofoni për shkak të inçizimit sepse në procesverbal po bëhen gabime.

Xhezide Dragusha – sa i përket procesverbalit të mbledhjes së kaluar, ne nuk do ta votojmë për arsyet se nuk i keni marrë parasysh kërkesat dhe sugjerimet tonë, që kanë të bëjnë me formimin e Komiteteve obligative. Poashtu, në procesverbal nuk është cekë fyerja që Kryetari na bëri neve si këshilltarë komunal, duke e quajtur Kuvendin si pazar, ndërsa asambleistët që nuk i janë bindur kërkesave e propozimeve të kualicionit qeverisës i krahason si dezter. Shfrytëzoj rastin të shprehë keqardhje për dëgjueshmërinë e juaj për të mos marrë pjesë në seancën e jashtëzakonshme, për të drejtat e femrave, të iniciuar nga LVV-ja.

Burim Gërguri – për këtë çështje mund të flasim në pikën “Të ndryshme”.

Ajet Berisha, Nënkyrytar i Komunës kérkon pauzë për të shkuar në homazhe.

Hysni Mjeku – kam një sugjerim Nënkyrytar, se ne në homazhe do të shkojmë, por ti orientoni punimet e Kuvendit, kur e kemi kryesuesin këtu, unë kérkoj falje prej teje.

Burim Gërguri – ne e kemi përcaktue se në orën 11 e 50’ do të shkojmë për homazhe, pastaj kthëhemë në mbledhje.

Hysni Mjeku – propozoj që herave tjera, të shkruhet miratimi i procesverbalit, e jo aprovimi sepse në nuk po aprovojmë Rregullore, por po miratojmë procesverbal. Te vendimi për formimin e Komitetit për komunitete, nuk e di a është gabim teknik apo jo kryesues sepse Nazmi Gashi (Nisma), unë nuk di ai a përfaqëson Nismën, apo LB-në. Nëse përfaqëson LB-në, atëherë duhet të hiqet ”Nisma” nga se nuk di tash se kend po e përfaqëson për shkak të informacionit. Poashtu, e shohë një gabim se është marrë vendimi për Draft Rregulloren për Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoba komunale, kur kjo ka qenë vetëm kërkesë dhe ne s’kemi pasë Rregullore, e këtu thuhet se jepet në diskutim publik pa kalue përmes KPF-së dhe pa ardhë në Kuvend. Te pika e tretë e rendit të ditës, te bartja e mjeteve nga viti 2017 në vitin 2018, thuhet pas shumë diskutimeve, merret ky vendim por këtu fare nuk shohë se dikush ka diskutue.

Burim Gërguri – procesverbal është vetëm nëse, ti je potencue dikund dhe të është humbë kuptimi i fjalisë, ndërsa në pjesën e dytë nuk keni qenë dhe në procesverbal Rregullorja për Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoba komunale, nuk është diskutue, por është dalë në debat publik. Tani, nga debati publik vjen në mbledhjen e ardhshme të KPF-së, pastaj në Kuvend aprovohet.

Hysni Mjeku – s’ka mund të dalë në debat publik pa kalue në KPF dhe ke mund me thënë vetëm është si kërkesë. Nëse, thuhet se është diskutue duhet të evidentohen diskutimet e këshilltarëve, që kanë qenë në vazhdimësi të seancës, por fare nuk ceken. Pika e 7 dhe 4 e rendit të ditës, kanë kalue pa kalue përmes KPF-së, kështu referoju LVL-së, pika 4, neni 7 çdo çështje që ka të bëjë me financa, nuk mund të kalohet

në Kuvendin komunal, pa kalue përmes KPF-së dhe kjo pikë kësisoji s'ka mund të kaloj sepse kemi të bëjmë me mjete financiare. Pajtoj me procesverbalin, por kur kemi të bëjmë me çështje të financave, nuk guxon të kalohet KPF-ja, sepse është Komitet obligativ që së pari çështja filtrohet aty, pastaj ju jepet asambleistëve.

Burim Gërguri – sekretaria e Kuvendit këto vërejtje do ti evidenton, por ju lutem që kur diskutoni ta keni mikrofonin sa më afër për shkak të inçizimit sepse po kemi probleme me mbajtjen e shenimeve.

Aziz Bici – unë e konsideroj të dëmshme vazhdimin e mbledhjes që i keni marrë ato vendime pa prezencën tonë sepse ne kemi pasë vërejtje dhe kemi mund të japim kontribut më tepër rreth atyre pikavë.

Burim Gërguri – fjala është për procesverbal z.Aziz, ju lus nëse dikund të është cekë emri apo rreth diskutimit tënd të kemi keqinterpretu për këtë jemi këtu, por ju e keni lëshue seancën kuorumi ka qenë dhe ne e kemi vazhdue mbledhjen.

Pas diskutimeve, këhilltarët komunal me 16 vota “Për” 5 vota “Kundër” miratuan ekstraktin e procesverbalit nga mbledhja e kaluar me vërejtjet e cekura më lartë.

IV.Pika e katërt e rendit të ditës –

Burim Gërguri – Rregullorja për ndarjen e bursave dhe kompenzimin e shpenzimeve të udhëtimit i ka kalue procedurat ligjore të debatit publik dhe më gjëresisht për ndryshimet në Rregullore, do të na njofton përfaqësuesja nga Drejtoria e Arsimit.

Fatime Pllana – Rregullorja paraprake ka pësuar disa ndryshime, jo aq të mëdha dhe këtu është bërë ndryshimi i kushteve për përfitmin e bursës. Ato fakultete që kanë qenë në Rregulloren e parë, nuk janë përcaktuar me prioritet dhe përparësi ju është dhënë disa fakulteteve. Si kusht për ndarjen e bursave është marrë nota mesatare e studentëve. Risi për këtë Rregullore, është se për herë të parë ndahet çmimi “Adem “Preniqi, i cili do të ndahet për studentin më të mirë në mesin e atyre që do të konkurojnë për vitin e ardhshëm. Risi tjetër e kësaj Rregulloreje është përfshirja e transportit, udhëtimi i nxënësve në relacionin shtëpi-shkollë, për të gjithë nxënësit e shkollave fillore, por do të përfshihen edhe ata të rasteve sociale. Arsyja pse është përfshirë edhe transporti në këtë Rregullore, është se disa herë ka pasë tenderim për transport dhe nuk kemi mund të shkojmë me tender sepse nuk konkuronte asnjë kompani serioze.

Fatos Kurshumlija – te neni 15 thuhet se ndarja e çmimit, bursave sipas kritereve të njejtë dhe nëse, disa studentë i kanë kriteret e njejtë, sipas nenit 14, atëherë çmimi ”Adem Preniqi” do të ndahet me short, ku shortin do ta përcaktoj Kryetari i Komunës. Unë propozoj që Komisioni vlerësues i studentëve njëherit të jetë edhe Komision i organizimit teknik të shortit, e jo të jetë i një individi cilido qoftë ai sepse vlerësimi atëherë nuk mund të jetë objektiv, por me shumë gjasa mund të jetë vlerësim subjektiv. Te neni 17, te kompenzimi i shpenzimeve të udhëtimit pika 1, thotë Komuna e Obiliqit do të bëjë kompenzimin e shpenzimeve në relacionin shtëpi-shkollë dhe anasjelltas për kategoritë e nxënësve, nëse distanca e udhëtimit është më shumë se 4 km. Unë propozoj që kjo distancë e bartjes së nxënësve, të ulet në 2.5 km kompenzimi i shpenzimeve të udhëtimit pika 1, thotë Komuna e Obiliqit do të bëjë kompenzimin e shpenzimeve në relacionin shtëpi-shkollë dhe anasjelltas për kategoritë e nxënësve, nëse distanca e udhëtimit është më shumë se 4 km. Unë propozoj që kjo distancë e bartjes së nxënësve, të ulet në 2.5 km. Psh një fëmijë në barrë e madhe për buxhetin e Drejtorisë së Arsimit, për mbulimin e shpenzimeve. Psh një fëmijë në klasën e 1,2, apo 3, të udhëtoj me atë çantën që e ka deri në 5 kg, 4 km në një drejtim dhe 4 km në drejtimin tjetër dmth 8 km, kur e dijmë ne sa qen endacakë janë në rrugë, irreziku në komunikacion për ata fëmijë, mendoj se kriteri prej 4 km duhet të ulet në 2.5 km.

Armend Rushiti – dua një qarim më detal te neni 9, pika 1.4, ku thotë se përjashtim nga pika 3, bëjnë pjesë studentët e fakultetit teknik, fakultetit të mjekësisë, mjekësia e përgjithshme, stomatologjia dhe farmacia, fakultetit të shkencave matematike natyrore, Departamenti i matematikës dhe Departamenti i fizikës. Studentët e këtyre lëmive të studimeve kanë të drejtë për bursë edhe me notë mesatare më të ulët se 8.5, por jo më pak se 7.5. Mendoj se këtu, ka dallime në mes të fakulteteve, por nuk është i njejtë si fakulteti teknik si ai i shkencave matematiko natyrore, me gjithë respektin për studentët por mendoj se fakulteti teknik është më i vështirë. Këtu, nuk është përfshirë as fakulteti i mjekësisë, që mendoj se në këtë pikë është dashur të përfshihet edhe ky fakultet.

Shaip Paloja – te neni 7, ku thuhet të jetë banor i Komunës së Obiliqit, mendoj se duhet të përcaktohet, një afat kohor sepse mund të ndodhë që dikush brenda javës bëhet banor i Obiliqit dhe e fiton bursën.Pra, të caktohet një afat 6 mujor ose 1 vjeçar, së paku të jetë 1 vjet banor i Komunës së Obiliqit.

Hysni Mjeku – te neni 5, formimi i Komisionit i është lënë në kompetencë Kryetarit të Komunës me zgjedhë dhe nëse, këtë Rregullore e aprovon Kuvendi komunal, mendoj se Komisionin duhet ta zgjedhë ky Kuvend komunal, e jo Kryetari i Komunës sepse Kryetari njëherit është edhe ekzekutues dhe nëse ne marrim vendim, atëherë ai duhet ta ekzekutoj.Te viti akademik thuhet se kanë të drejtë vetëm studentët që e kalojnë vitin e dytë e mëtutje, por ne tash nuk po japim mjete për kuadra sepse populli shqiptar ka mjaft kuadra, ka mbi 8 universitete. Ne po japim mjete financiare për ti ndihmuar njerëzit në nevojë, pse të bëhen dallime kësosoji. Unë nuk e di se cila Komunë sot vuan për kuadra dhe ne po ju japim mjete për t' ju ndihmuar njerëzve, që vërtetë e kanë një gjendje ekonomike të dobët. Në nenin 9, thuhet të jetë student në nivelin e studimeve themelore bachelor, atëherë pse përjashtohet masteri dhe nëse ne lidhemi tash për kuadra a është kuadër bachelori apo masteri. Mendoj se duhet të përfshihet edhe masteri sepse po e përjashtojmë një kategori jetike për Komunën. Psh pse ti jepet përparësi shkencave natyrore, për çfarë arsyesh psh ai që e studjon gjuhën angleze mos të ketë bonus, ose atij ti zvoglohet psh nota mesatare kur ai e ka zgjedhë teknikun dhe me teknikun le të përballohet, pse të bëjmë kësot dallime. E kemi largue fakultetin e mjekësisë siç e tha kolegur dhe e kemi fut një fakultet psh Departamentin e matematikës, që ne po e bëjmë kaq të madhe shumë dhe shohë pse 7.5 psh e ky 8.5, ndarje e kategorive të njerëzve kësosoji kur secili e ka përcakue profesionin e vet.Të neni 6, 16, pika 1,2 te nxënësit e SHMUP "Ismail Dumoshi" pse të përjashtohen nxënësit e gjimnazit kur e kemi elitë të nxënësve. Ne vetyven po e degradojmë kësosoji po i japim përparsi profesionales, ndërsa po e degradojmë një elitë shkollorë, që vërtetë ia kanë lakmi edhe ne si Komunë dhe në përgjithësi. Mendoj se duhet të futen këtu, edhe nxënësit e gjimnazit. Te lartësia e kompenzimit të udhëtimeve, neni 18, unë nuk po e kuptoj apo është gabim teknik sepse absolutisht kurgjë nuk shkruhet.

Fatime Pllana – përgjegjet se është gabim teknik.

Hysni Mjeku – nëse, është gabim teknik duhet me u deklarue sepse këshilltarët e kanë Rregulloren përparrë dhe absolutisht nuk e kuptoj se çka ka dashur me thënë këtu. Formimi i Komisionit duhet të jetë prej 3,5 ose 7 anëtarëve dhe të jetë Komision i përzier në përbërje prej 70 %, nga kuvendarët sepse ne i ndajmë mjetet. Te kontrata e kompenzimit të bursës duhet të precizohet se a është kontratë 1 vjeçare, me mundësi vazhdimi apo 2 vjeçare, duhet të ceket këtu, kuptohet nëse i plotëson kriteret sepse me kontratë ai vitin e ardhshëm nuk ka nevojë me konkurue.Të neni 25, arsyeva pse po e bëjmë ndryshimin e kësaj Rregulloreje, plotësisht pajtoj por vërtetë këto vërejtje duhet tëjenë pjesë e Rregullores së ardhshme.

Aziz Bici – te Rregullorja për ndarjen e bursave dhe kompenzimin e shpenzimeve të udhëtimit deshta të flas edhe unë, por foli edhe z.Hysni te neni 16, pika 1,2 kërkoi sqarim ose duhet të përfshihen nxënësit e 2 shkollave.

Fatmir Bekteshi - deshta me dhënë një vërejtje te Drejtoria e Arsimit, se kjo a është pikë e veçantë.

Burim Gërguri – përgjegjet po.

Fatime Pllana – përgjegjet te neni 5, për formimin e Komisionit kemi punue dhe jemi konsultue me anëtaren e Komisionit, zyrtaren ligjore Drita Hashanin dhe kështu kemi ardhë në përfundim duke krahasuar një numër të madh të këtyre Rregulloreve, në Komunat tjera.Të neni 7, u kërkua që së paku secili student të jetë banor i Obiliqit, si kusht për ndarjen e bursave pika 1.1, që ne nuk e kemi përcaktue. Sinqerisht nuk e di se a ka kriter të veçantë kur një qytetar konsiderohet banor sepse e di se përparrë ka qenë 5 vite, por tash nuk e di a ka ndryshue.Të neni 9, kërkohet që për ndarje të bursave patjetër të përfshihet edhe masteri dhe Drejtoria ka konstatuar se SHM ka pasë një zvoglim të numrit të nxënësve më heret dhe në mënyrë që ti sjellim nxënësit e mirë, që të mos na shkojnë në Komunat tjera, kemi paraparë që të ndahen bursa për nxënësit që kanë suksesin e shkëlqyeshëm. Poashtu, konsiderojmë se maturantët që përfundojnë gjimnazin kanë shumë përparësi të marrin bursa sepse numri më i madh i nxënësve të gjimnazit në Obiliq, janë studentë të cilët studjojnë, ndërsa numri shumë më i vogël është i atyre nga

shkolla profesionale "Ismail Dumoshi". Bursa me përparësi për studentë të shkencave natyrore është paraparë sepse konsiderojmë se në fakultetet e shkencave shoqërore, në Obiliq shumë më tepër kemi studentë që kanë diplomue. Te neni 9, pika 1.2, është paraparë që përfituesit e bursës të janë studentë së paku në vitin e dytë të studimeve sepse ne nuk mund t'ju japim bursa atyre, që sapo kanë fillue se shumica nganjëherë nuk kanë as semestrale, si kusht dhe është marrë kriter edhe prej Rregulloreve të Komunave tjera. Sa i përket gjendjes ekonomike janë paraparë edhe rastet sociale, fëmijët e dëshmorëve dhe kategoritë tjera. Poashtu, është kërkuar të përfshihet edhe fakulteti i mjekësisë, por ne si Komision kemi konsideruar që të janë vetëm këto 2 fakultete. Te neni 1.3, të kenë notë mesatare të studimeve së paku 8.5, te neni 1.4, përjashtim nga pika 3, të bëjnë pjesë studentët e fakultetit teknik. Te pika 3, Kryetari i Komunës, në Këshillin e drejtoreve merrë vendim për shumën financiare të bursës, që ndahet për një vit akademik. Pra, duhet të përfshihet fakulteti teknik, fakulteti i shkencave matematike natyrore, Departamenti i matematikës dhe Departamenti i fizikës. Studentët e këtyre lëmive kanë të drejtë për bursë edhe me notë mesatare më të ulët se 8.5, këta do të janë përfitues dhe jo më pak se 7.5. Te neni 16, pati kërkesa që të përfshihet edhe gjimnazi "17 shkurti", e jo vetëm SHMLP "Ismail Dumoshi" dhe unë e dhashë mendimin se është kërkuar që shkolla profesionale të ketë nxënësa më të mirë, njëkohësisht gjithmonë ish nxënësit maturantë të gjimnazit në mesin e 50 bursave, marrin më tepër bursa se sa këta të shkollës profesionale. Te neni 17, te pika 1.1, km të zvoglohet për 2.5 km dhe këtë nuk mund ta bëjmë sepse me Ligjin e Arsimit parauniveristar është caktuar saktë së paku 4 km. Këtu, u tha se neni 18, nuk lexohet fare dhe tash po ju lexoj komplet nenin 18, Lartësia e kompenzimeve të udhëtimit: "Kryetari i Komunës në Këshillin e drejtoreve, merrë vendim për shumën, lartësinë e kompenzimit të shpenzimeve të udhëtimit në relacione të udhëtimit shtëpi -shkollë dhe anasjelltas, por për secilën kategori të nxënësve veç e veç" sipas nenit 18. Mirëpo, këtu është bërë gabim teknik sepse duhet të jetë neni 17, kërkoi falje. Te neni 22, bursat duhet të ndahen për vitin akademik 2017- 2018 dhe kontrata lidhet gjithmonë për këtë vit akademik. Në fillim të Rregullores është cekë se kjo Rregullore është për vitin 2017-2018, vitin shkollor dhe vitin akademik.

Fatos Kurshumlija – znj.përfaqësuese e Drejtorisë së Arsimit, nenin 15 që e ceka nuk u more fare me atë çështje, te vlerësimi i studentëve nëse janë dytë me kritere të njejtë dhe unë propozova që Komisioni i cili i vlerëson studentët të jetë ai i cili e cakton shortin si ka me qenë, e jo një individ.

Fatime Pllana – kërkoi falje, që e kalova këtë nen, por ju materialin e keni dhe është paraparë në këtë formë. Kjo bursë ndahet për herë të parë te na dhe kështu e ka paraparë edhe Komisioni.

Kryetari – edhe me nda Kryetari nuk bën ndonjë farë gabimi sepse gjithsesi Kryetari ia jepë Komisionit prapë me vlerësue, por ai mund të jetë një rast sui generis, ndoshta njëherë në 100 vjet me qenë me pika e rezultat të njejtë. Mbi të gjitha, nuk po ia lëmë hiç Komisioit, as Kryetarit por le të vendosë Kuvendi.

Agim Spahiu – sqaron se fakulteti i mjekësisë nëse, nuk është në këto kategoritë teknike, është në kategorinë e parë, që duhet të jetë mbi 9, ndërsa këtu është zbrit 8.5. Në fakultetin e mjekësisë sipas statistikave, që i kemi studentët kanë një notë mesatare bukur të lartë dhe nëse, e zbresim dhe e futim edhe fakultetin e mjekësisë në një nivel 7.5, atëherë përvèç fakultetit të mjekësisë, që do ta marrin ndoshta gjysmën e numrit të bursave, studentët tjerë nuk do të marrin. Pra, është një fakultet që dultret punë dhe zell për me krye, por në atë fakultet shkojnë relativisht nxënësit e përgatitur dhe e arrijnë notën 8.5. Ne si model e kemi marrë bursën universitare, qysh i kanë kategorizue fakultetet.

Fatmir Bekteshi – u tha se Ministria përkatëse e ka caktuar distancën prej 4 km, por nëse ka mundësi buxhetore dhe kjo është për të mirën e fëmijëve tonë, nëse mund të ndërhyjmë në atë ligj për me bë shkurtimin e distancës sepse unë vijë nga Breznica dhe ka shumë kërkesa për këtë çështje.

Kryetari – e kuptojmë shqetësimin e juaj sepse përditë ju keni të bëni me këtë shtresë të njerëzve, por përvèç bursave ne krijojmë Komisione ad hoc, për raste specifike të njerëzve të cilët e kanë gjendjen sociale, që ne kemi veprue dhe veprojmë vazhdimisht. Ne mund ta ngritim si shqetësim në Asociacion të Komunave, për plotësim të ligjit, por kështu është dhe nuk mund ta ndryshojmë Rregulloren sepse distanca e udhëtimit të nxënësve është e përcaktuar nga Ministria përkatëse.

Hysni Mjeku – arsyen nuk e tha pse gjimnazi mos të jetë, por vetëm kemi marrë shembull që e potencoi përfaqësuesja e Drejtorisë së Arsimit, sepse ne po bëjmë Rregullore për banorët tonë, dhe mua nuk më intereson fare se çfarë bën Drenasi, ose Departamentet nuk guxojnë këtu të përfshihen. Ne jemi ata që i përfaqësojmë edhe Departamentet sepse mjetet janë tonat dhe asnjë arsyje ajo nuk e paraqiti.

Kryetari – sqaron kur kemi nisë me nda bursën për nxënësit e shkollës profesionale teknike, kanë qenë vetëm 2 nxënës, me sukses të shkëlqyeshëm dhe kjo ka qenë arsyja fillestare me i stimulue nxënësit me vazhdue mësimin në shkollën profesionale "Ismail Dumoshi" dhe nga ky numër është arritë numri në 33. Tani, pse është bërë dallim në mës të gjimnazit dhe teknikës, nëse marrim të njejtin kriter me gjimnazin, ne duhet t'ju japim gjithë gjimnazit bursa sepse atje normal regjistrohen vetëm nxënësit e shkëlqyeshëm. Pastaj, mundësia jonë buxhetore nuk mundet me arritë, por te rastet sociale nxënësit që gjatë studimeve, përqindje shumë më shumë përfitojnë bursa nxënësit e gjimnazit se sa të shkollës profesionale. Ne këtu, jemi munduar të bëjmë një barazim që me pasë përfitim në një periudhë kohore një pjesë, ndërsa në një periudhë pjesa tjeter.

Pas diskutimeve, këshilltarët komunal unanimisht morën këtë:

V E N D I M

Aprovohet Rregullorja për ndarjen e bursave dhe kompenzimin e shpenzimeve të udhëtimit.

V.Pika e pestë e rendit të ditës -

Agim Spahiu – paraprakisht është një lëshim teknik në faqen e parë, lista e punëtorëve që kanë dalë në pension nuk është 2005-2013, por është 2001-2018. Tërësisht janë 65 me emër e mbiemër nga viti 2001 deri në vitin 2018. Të gjithë këta ish mësimëdhënës që janë në pension janë të mbuluar me kontrata kolektive, të nënshkruara nga SBASHKU dhe Ministria e Arsimit, me përjashtim të 2 ish punëtorëve, të parë të cilët janë në pension dhe janë jashtë kontratave kolektive. Kontrata e parë kolektive është nënshkruar në vitin 2005, që ishte valide deri në vitin 2014, kontrata e dytë prej vitit 2014-2017 dhe e fundit është 2017-2020. Shuma afersisht që i duhet Drejtorisë së Arsimit për me i krye këto obligime është 95,895 €, dhe kërkoi nga Asambleja, që të aprovon këtë kërkesë për kryerjen e obligimeve ligjore, ndaj ish të punësuarve në Arsimit. Poashtu, kërkoi që për punëtorët nën numrin rendor 1 dhe 2, të merret një vendim që edhe këtyre të ju kompenzohet kontributi që e kanë dhënë në Arsimit, sipas kontratës pasuese kolektive.

Fatmir Bekteshi – e kam një vërejtje te lista e pensionistëve në Breznicë, sepse janë 2 persona të quajtur Ali Krasniqi, është njëri që ka shkue në pension, ndërsa tjetri është aktiv ende punon dhe pyetja ime është pse figuron këtu në listë.

Agim Spahiu – përgjegjet se janë 2 persona me emrin Ali Krasniqi, dhe ju takon pensioni.

Hysni Mjeku – e kemi diskutuar këtë çështje në KPF dhe vendimi ka qenë pa përjashtim, të gjithë punëtorët arsimor të cilët kanë shkue në pension t'ju takoj një e drejtë e tillë. Unë edhe në KPF dhe tash jam pro vendimit, që do të thotë të gjithë punëtorët e Arsimit duke marrë parasysh kontributin e dhënë në kohën më të vështirë dhe në shtetin e vet të anashkalohen, unë besoj se kemi bërë një gabim të madh. Unë e përkrahu edhe vullnetin e mirë të Kryetarit, të anëtarit të KPF-së, por njëkohësisht edhe të kuvendarit që vërtetë ta përkrahim një vendim të tillë dhe asnjë punëtorë i cili ka shkue në pension të mos mbetet pa e realizue këtë të drejtë.

Shaip Paloja – edhe ne në parim e mbështesim këtë kërkesë, por kërkoi një sqarim sepse këtu në fund thuhet se kjo kërkesë nuk përkon përvëç të punësuarit në Arsimit, të cilët janë të pensionuar dhe janë në proces gjygjësor, apo kanë ndonjë vendim të formës së prerë të organeve gjygjësore për këtë çështje.

Hysni Mjeku – listën e këtyre kandidatëve, unë edhe në KPF e kam kërkuar, por tash e mora këtë listë. Një gjë duhet me ditë se ai që e ka fitue procesin gjygjësor dhe mjetet i ka marrë, nuk ka logjikë të hyjë këtu në listë, por edhe ata që ende nuk e kanë fituar kontestin nëse, ne ua mundësojmë e përfshijmë në listë, ia japim mjetet dhe ai duhet të tërheqë padinë sepse nuk ka logjikë të fitoj edhe atje, edhe këtu. Mendoj se arsimtarët kanë dhënë më tepër se sa që ne tash po ju japim dhe nuk besoj se do të kërkojnë.

edhe përmes Gjykatës dhe përmes neve. Unë e përgëzoj një vendim të tillë, i përgëzoj edhe ata që deri më sot nuk kanë pasë mundësi, por njëkohësisht edhe ata që ia kanë ndalue një mundësi të tillë dmth pse kanë lejue një grumbullim të problemeve në Arsim.

Kryetari – meqë, kjo çështje ka impakt buxhetor, ne planifikojmë edhe me rishikim të buxhetit. Është shumë fat i mirë se që nga viti 2014, jemi e vetmja Komunë, që e kemi realizue këtë beneficion për të gjithë të pensionuarit. Edhe vendimin që do ta nxjerrim, nuk do të thotë se ne e kemi përbyllë punën derisa nuk i sigurojmë mjetet buxhetore me rishikim të buxhetit.

Nazmi Gashi – unë nuk kam punuar në Arsim, por kisha pasë dëshirë të kisha qenë në Arsim, vetëm për të pasë një drejtor siç e ka tash Drejtoria e Arsimit, që duhet me ia dhënë një mirënjohnje, një falenderim të madh për tërë mundin që e ka bërë. Vërtetë, arsimtarët para luftës kanë qenë të vetmit ata që e kanë marrë një pjesë të pagesave, me rreziqet që kanë qenë, por diçka kanë bërë. Mirépo, ka pasë shumë kuadra që kanë kontribue dhe nuk kanë mund me ardhë deri te pagesa kurrsesi, por fati është kend e ke udhëheqës. Në fund e falenderoj drejtorin dhe e lus që të gjithë atyre, që ju takon kjo e drejtë të hyjnë në listë.

Agim Spahiu – duhet me i detalizue 2 komente, që janë shumë të rëndësishme një është rasti i 2 punëtorëve të parë që nuk janë brenda kontratave, dhe kjo duhet të specifikohet në vendim.

Kryetari – mendoj se ka forma tjera, për me zgjidhë problemin e tyre ose në formën e subvencionit, ose përmes Ministrisë sepse ne si Kuvend nuk mund të përcaktojmë kontratën kolektive.

Agim Spahiu – sqaron se ka pensionistë që janë në procese gjygjësore dhe derisa të udhëheqet një proces gjygjësor procedurat tjera pushojnë. Kuvendi mund të nxjerrë vendim që t'ju lejohet edhe atyre nëse sjellin dëshmi se e kanë tërheqë padinë ose e kanë ndërprerë procedurën gjygjësore.

Pas diskutimeve, këshilltarët komunal unanimisht morën këtë:

V E N D I M

Aprovohet kërkesa e Drejtorisë komunale të Arsimit (DKA) për pagesën e të gjitha obligimeve për ish të punësuarit në Arsim në Komunën e Obiliqit, të cilët gjer më tanë nuk e kanë realizuar këtë të drejtë me rastin e pensionimit të tyre si obligim i punëdhënësit (sipas kontratave kolektive të Arsimit Parauniversitar).

VI.Pika e gjashtë e rendit të ditës –

Burim Gërguri - ju e dini se e kemi Rregulloren e punës së Kuvendit, që nga viti 2008 dhe tash e kemi kërkesën për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores në fjalë. Unë propozoj që kjo Rregullore të dalë në diskutim publik.

Pas propozimit të kryesuesit të Kuvendit komunal, këshilltarët komunal unanimisht morën këtë:

V E N D I M

Për dhënien në diskutim publik të Rregullores së punës të Kuvendit komunal.

Ajet Berisha - është dashur të formohet një grup punues për hartimin e Rregullores së punës së Kuvendit komunal dhe mendoj se kam të drejtë me marrë fjalën si Nënkyetar Komune, për cilëndo pikë që ma merrë mendja se mund të kontriboj.

Shaip Paloja – propozon z.Fatos Kurshumlija, anëtar të Komisionit.

Lulzim Sadiku – propozon z.Hysni Mjeku, anëtar të Komisionit.

Enver Gashi – propozon z.Agon Mjekiqi anëtar të Komisionit.

Xhezide Dragusha – propozon z.Aziz Bici, anëtar të Komisionit.

Pas propozimeve, këshilltarët komunal unanimisht morën këtë:

V E N D I M

Formohet Komisioni për hartimin e Rregullores së punës të Kuvendit komunal me këtë përbërje:

1. Drita Hashani, Kryetare
2. Fatos Kurshumlija, anëtar
3. Agon Mjekiqi, anëtar
4. Hysni Mjeku, anëtar

5. Aziz Bici, anëtar

VII.Pika e shtatë e rendit të ditës –

Burim Gërguri – kërkon të formohet grupi punues për hartimin e Planit të punës të Kuvendit komunal për vitin 2018.

Enver Gashi – e propozon z.Labinot Mirena.

Shaip Paloja – propozon z. Fatmir Bekteshi.

Armend Rushiti – propozon z.Nazmi Gashi.

Hysni Mjeku – propozozn z.Lulzim Sadiku.

Pas propozimeve, këshilltarët komunal unanimesht morën këtë:

V E N D I M

Formohet Grupi punues për hartimin e Planit të punës së Kuvendit komunal me këtë përbërje:

1. Labinot Mirena, Kryetar
2. Fatmir Bekteshi, anëtar
3. Nazmi Gashi, anëtar
4. Lulzim Sadiku, anëtar
5. Slavisa Spasic, anëtar

Kryetari – e kam një kërkesë rrëth këtij Komisioni, se kishte me qenë mirë që java e tretë me qenë përmbyllëse e Kuvendit, me qëllim që me pasë afat një javë Ekzekutivi që kërkesat, vendimet, buxhetin me mund me i procedue nëpër Ministri.

VIII.Pika e tetë e rendit të ditës –

Lulzim Sadiku – propozon që të shtyhet kjo pikë e rendit të ditës, sepse jemi lodhë.

Aziz Bici – arsyaja e shtyerjes së raportit eshtë që ne të mund të japim kontribut më shumë rrëth shqyrtimit dhe mendoj se shkon edhe në interesin e juaj. Ne kemi gjetë diçka, që do të kërkojmë disa sqarime, por në kohën kur na eshtë dorëzuar nuk kemi mund sepse i ka dikund rrëth 76 faqe.

Kryetari – sa i përket raportit të punës, mos t'ju vjen keq fare për çdo procedurë që ne e inicojmë për punë, për projekte kurdoherë që juve ju intereson edhe në qasje të dokumenteve, ka mundësi edhe më i vizitue vendpunimet pa asnjë problem.

Burim Gërguri - për shkak të procedurës ligjore, afatit eshtë paraparë që raporti i Kryetarit të shqyrtohet në këtë seancë dhe tani do të debatojmë.

Shaip Paloja – ky raport eshtë mjaft voluminoz, ka shumë tabela dhe shifra, që mendoj se ka edhe të arritura të Komunës. Një prej të arriturave, të mira, të domosdoshme eshtë ndërtimi i shkollës në Lajthishtë, që ka qenë një projekt mjaft i qëlluar. Poashtu, eshtë projekt i pastrimit të lumbit Sitnica, me disa përrrocka. Mendoj se lumi Sitnica, ka pasë shumë nevojë të pastrohet dhe propozoj që ky projekt të vazhdoj dmth të mos përfundoj për një kohë të gjatë, por gjithsesi inspeksioni komunal të jetë i gatshëm ta kontrolloj kohë pas kohe sepse aty hudhin edhe mbeturina. Te DKRS-ja, nga bartja e mjeteve prej vitit 2017 kërkoj sqarim për mjetet e mbetur rrëth 12,000 €, pse kanë mbetë, a ka pasë mungesë të projekteve, apo nuk janë përkrahë projektet. Te Drejtoria e bujqësisë, kam një pyetje nëse ka mundësi e kisha me kërkue listën me emrat e përfituesve, nga Ministria e bujqësisë ku janë përfituar 684 krerë lope, 841 dele dhe 2,687 bletë.

Hysni Mjeku – paraprakisht e falenderoj Kryetarin për një raport dhe me këtë po shihet qartë se Kryetari eshtë i gatshëm me qenë i hapur për çdokend dhe besoj se ky raport reflekton shumë gjëra. Në raport janë të paraqitura më se 80 %, të projekteve të qëndrueshme, që unë e falenderoj. Te Kryetari, e kam vetëm një vërejtje për çështje të Hades, që në raport pak eshtë shkruar. Te çështja e ambullantës në Shipitullë është në Palaj, kemi pak të dhëna, pse nuk aktivizohen këto ambullanta. Te stafi mbështetës, apo te 4 shtyllat e Kryetarit nuk kemi raport të detalizuar, raporti i Personelit, raporti i zyrtares ligjore, raporti i auditimit dhe raporti i Prokurimit, kemi pak informacione. Kërkoi që në të ardhmen të kemi më shumë informacione sepse këto 3 kategori, nëse funksionojnë mirë, atëherë edhe Kryetari ka me qenë shumë funksional dhe i suksesshëm. Edhe pse nuk kam informacion, në parim e përkrahu raportin, që eshtë raport shumë i detalizuar, por në këto segmente nuk kam hasë në ndonjë informacion sa i përket neve

kuvendarëve. Te subvencionet, te ndarja e bursave, të jemi sa më informativ, e jo të marrim informata përfundimtare se kemi një regjistër se kush ka përfitue, e kush jo. Te çështja e Personelit, pse ne të mos kemi informacion se sa njerëz janë me kontratë mbi veprën, çka kanë krye dhe për çka janë angazhue ata. Te çështja e financave, e nderuara drejtoreshë në të ardhmen duhet të na japësh një raport edhe në formë sintetike dhe analitike, në mënyrë që ne të kemi informacione të sakta.

Fatos Kurshumlija – e falenderoj Drejtorinë e Arsimit, për realizimin e projektit të SHF “Fazli Grajqevci” në Lajthishtë, që fillimisht ishte një projekt mjaf i nevojshëm përfundimtare, por është shumë problematikë hapësira e objektit shkollor, pothuajse e njejtë me atë që është ndërtuar para 50 viteve. Në atë objekt të ri nuk ka hapësirë komplet prej klasës së parë deri në klasën e tetë. Te tabelat e prezantuara përfundimtare suksesin e nxënësve të SHM, nuk është prezantue pasqyra e shkollës teknike “Ismail Dumoshi”. Në atë tabelë shihet vetëm suksesi i gjimnazit “17 shkurti” ku në gjysëmvjetorin e parë shihet një sukses tejet i dobët i nxënësve, ku vërehet se prej 787 nxënësve, fatkeqësisht 439 janë me një ose më shumë nota të dobëta. Unë kisha me kërkue prej udhëheqësisë aktuale, që ti kushtoj më tepër vëmendje në veçanti Arsimit dhe suksesit të nxënësve.

Aziz Bici – sigurisht se ka suksese, ka projekte të mira, që ia vlen me i lavdëru pa dallim që do të thotë se në të ardhmen kemi me i pa edhe mangësitë, që do ti ketë sepse vërtetë neve materiali na është dorëzuar vonë dhe s’kemi mund me lexue mjaftueshëm. Te ndërtimi i shkollës në Lajthishtë, buxheti është 153,100 €, shpenzimet 144,000 €, por te totali diferenca nuk është paraqitë dhe për këtë kërkohet sqarim. Gjithashtu, edhe te ndërtimi i objekteve ndihmëse në QKMF, është një diferenca e vjetër dhe te rregullimi i parqeve dhe shesheve dmth rrëth këtyre një sqarim me na dhënë që ne ta kuptojmë më mirë.

Zarife Behluli – sqaron te DKRS-ja, që u tha se kanë mbetë 12,000 €, dhe unë nuk e di se ku i ke pa ato 12,000 €, sepse te DKRS-ja, në kategorinë e mallrave janë vetëm 46.22, që kanë mbetë bartje dhe te subvencionet janë 46.97 centë, të pa shpenzuara që në total janë 93.19. Te këshilltari z. Hysni Mjeku, unë ju kam sjellë reportin përfundimtare për se cilën Drejtori vëç e veç dhe ajo është analitike dhe sintetike përfundimtare. Përkatëse sa kanë pasë buxhet me grand, me të hyra, me të bartura, sa ka shpenzim me grand, me të hyra dhe me të bartura dhe totali sa ka pasë të lira. Te shkolla në Lajthishtë, 153,100 €, ka qenë buxheti, shpenzim është 144,906 €, pjesa 8,193 është që i ka marrë Ministria në fund të vitit sepse nuk kemi pasë përfundimtare që me i zhvillu procedurat që me i shpenzue këto mjete.

Hysni Mjeku – pyes pse ambullanta në Shipitullë dhe Palaj nuk funksionon, a është përfundimtare shkak të mjetave material apo ka mbetë më vonë.

Zarife Behluli – sqaron se te ndërtimi i objekteve ndihmëse në QKMF, kanë qenë procedurat e Prokurimit, por nuk ka mund të kryhet puna dhe një pjesë është pagu, ndërsa pjesa tjetër mbetet përfundimtare. Te rregullimi i parqeve dhe shesheve 10,000 €, kanë qenë grand, 10,000 të hyra, në total 20,000 €. Disa procedura të Prokurimit janë zhvilluar, por tenderi ka dështuar sepse nuk ka pasë operatorë dhe këto mjete barten në vitin 2018.

Ferid Hashani – i përgjegjet z. Shaip Palojs, se ne me dhi qumështore në vitin e kaluar i kemi mbështetë 31 familje, ndërsa tabelat janë përfundimtare e Komunës së Obiliqit që kanë përfitue përmes Drejtorisë së bujqësisë. Ne nuk jemi ata që ju kemi dhënë në këtë rast me projekt të caktuar, por vetëm përmes Drejtorisë së bujqësisë, kanë aplikuar në Ministri të bujqësisë dhe kanë përfitue.

Shaip Paloja – në reportin që ne e kemi marrë te Drejtoria e bujqësisë, thuhet se përfitimet kanë ardhë nga Ministria e bujqësisë, por konkurrimi ka qenë përmes Drejtorisë së bujqësisë të Komunës. Mua, më intereson ju me na i dhënë emrat e përfituesve. Te Drejtoria e financave, në reportin e bartjes së mjetave prej vitit 2017 në vitin 2018, nga DKRS-ja, kërkohet bartje rrëth 12,900 €, dhe unë nuk e di a është gabim teknik, apo jo mirëpo aty figuron.

Agim Spahiu – i përgjegjet z. Fatos Kurshumlisë, se rubrika e fundit është përfundimtare përfundimtare, janë në 2 shkolla dhe mbi tabelë statistika, shkruan suksesi i nxënësve në gjysëmvjetorin e parë të vitit 2017-2018, niveli i shkollimit SHMLT dhe gjimnazit. Një shqetësim që e ngriti ishte hapësira e shkollor 2017-2018, sikurse e viteve të 60-ta, por shkolla punohet përfundimtare numrin e njejtë e ndërtuar e shkollës në Lajthishtë, sikurse e viteve të 60-ta, por shkolla punohet përfundimtare numrin e

nxënësve dhe ndoshta, në vitet e 60-ta, keni pasë më shumë nxënësa se tash. Hapësira shkolllore nuk është problem, por numrin e nxënësve në projekt arkitektonik e kemi paraparë më tepër se sa që i ka nevojat aktuale. Është një objekt original i projektuar, i ndërtuar për herë të parë me buxhetin komunal. Z.Hysni, me shumë të drejtë e ngriti çështjen e subvencioneve, me theks të veçantë te bursat që të janë transparente se mund të ketë paragjykime dhe sigurisht se ka paragjykime sepse ndahen 50 bursa, aplikojnë 150, prej tyre 100 paragjykojnë. Një ndër qëllimet dhe funksionet e Rregullores, që e miratuam është që të zvoglohet ndoshta, të eliminohet në tërësi paragjykimi dhe manipulimi me rastin e ndarjes së bursave. sepse tash ndahet absolutisht në bazë të notës mesatare. Kuvendi komunal e formon Komisionin për ankesa dhe përmes atij Komisioni mund të jeni direkt të informuar në mënyrë transparente.

Ibush Mjekiqi – sqaron se nuk është vetëm në Shipitullë, por janë 3 AMF, që nuk funksionojnë në kuadër të sistemit shëndetësor parësor të cilin ne si Komunë, jemi të obliguar ta ofrojmë, ashtu i kemi gjetë dhe në bazë të analizave që i kemi bërë në vitin 2014, i kemi caktuar edhe prioritetet në mandatin e kaluar se çka duhet me bë. Unë besoj se në këtë mandatë të gjitha AMF-të, që janë jashtë fumksionit mund të funksionalizohen duke i pasë për bazë 2 faktorë kryesor, faktorin njeri she resurset humane sepse ne nuk e kemi numrin e mjafueshëm të personelit shëndetësor. Ky numër ka fillue prej vitit 2000-2001, dhe nuk është ngritë asnjëherë, ndërsa shërbimet te ne janë ngritë dhe faktori tjeter është faktori financiar që nuk lejon të ofrohet shërbim shëndetësor në disa vende ku shpenzimet janë shumë më të mëdha se sa ofrimi i shërbimeve shëndetësore. Në mungesë të kësaj, ne bëjmë vizita shtëpiake të përditshme dhe të gjithë personat që janë të sëmurë rëndë, ne ju japim shërbime shëndetësore në shtëpitë e tyre.

Ferid Hashani – sqaron se këto subvencione janë grandet qeveritare dhe cecili fermer në Komunën e Obliqit, mbështetet prej Ministrisë dhe ai aplikon në Komunën tonë, përmes Ministrisë, ndërsa mjetet i derdhen në xhirollgarinë private. Ne i marrim të dhënat e njerëzve që aplikojnë, ndërsa nxjerrjen e emrave e bën Ministria.

IX.Pika e nëntë e rendit të ditës –

Burim Gërguri – e kemi një kërkesë nga DSHPE-ja, për iniciimin e procedurës për hartimin e Draft Rregullores për shfrytëzimin e veturave zyrtare dhe tani propozoj që kjo Draft Rregullore të dalë në diskutim publik.

Pas propozimit të kryesuesit të Kuvendit komunal, këshilltarët komunal unanimisht morën këtë:

V E N D I M

Për dhënien në diskutim publik të Rregullores për shfrytëzimin e veturave zyrtare.

X.Pika e dhjetë e rendit të ditës -

Burim Gërguri – kemi kërkesën nga Kryesia e fshatit Bakshi për iniciimin e procedurës për këmbimin e pronës komunale me atë private.

Kryetari – për neve faktikisht është një pozitë më e favorshme dhe lidhet me infrastrukturën e fshatit, ndërsa pjesa tjeter mbetet që ta vlerësoj Komisioni i përbërë prej Ekzekutivit dhe Kuvendit.

Lulzim Sadiku – dua të di nga drejtori se ky këmbim prone a është i ligjshëm, në mënyrë që ne të procedojmë më tutje.

Fatmir Bërbatovci – Ligji nr.04-L, 144 e parashevë procedurën e këmbimit të pronave dhe Komisioni i formuar do ta merrë parasysh me rastin e prezentimit në Kuvend.

Aziz Bici – lexon kërkesën nga Kryesia e fshatit Bakshi. Kërkoj të merren parasysh shumë gjëra sepse në këtë mbledhje nuk dihen sa banorë kanë qenë kur është marrë vendimi sepse aty thuhet në mbledhjen e fshatit dmth nuk kemi informacione, nuk kemi arsyë të mjafueshme për këtë këmbim prone. Pastaj, duhet ta kemi kopjen e planit dhe Komisioni duhet të dijë se ku është sepse dyshoj se mos është puna e çmimit në m^2 që mund të dalloj psh në Mazgit, brenda në fshat shkon prej 800, 1000-2000 €, ndërsa afër rrugës atje shkon prej 5000-6000 €. Në rast se kërkesa e banorëve, vëretetë është në interesin e fshatit, mendoj se kjo duhet të bëhet, por me kaq kërkesë absolutisht kjo nuk duhet të merret parasysh.

Shaip Paloja – më habit fakti se për një ndërrim të tokave, kërkon Kryesia e fshatit për një pronë private, ai ka emër dhe mbiemër dmth është për me u habit pse kërkon Kryesia e fshatit, për ndërrimin e tokës të një pronari, që sipas të gjitha gjasave është pronari. Ai në të ardhmen mund të kundërshtoj dhe ne nuk kemi diçka konkrete prej tij. Unë dua të di se ku është interes i publik, çka planifikohet në atë tokë sepse nëse ne vazhdojmë kështu, të gjithë ne e kemi dikund një tokë më largë dhe kemi dëshirë me ndërrue me tokë të Komunës, për me ofue më afër shtëpisë dhe kam frigë se ky zinxhir do të vazhdoj. Kërkoi sqarim se ku është interes i publik dhe a është marrë miratimi i pronarit sepse më vonë mund të kemi problem.

Kryetari – ju njoftoj se pronari aktual është Hashim Berisha, e ka një pronë ngjitur për xhami dhe faktikisht pronën ku ne e kemi një pjesë është deponi e mbeturinave. Nëse, ne e zhvillojmë si kompleks sportiv atje ku ne aktualisht e kemi parcelën, nuk do të jetë e shftytëzueshme për qytetarët e Bakshisë sepse distanca është mjaft largë. Ndërsa, ndërrimi i pronave neve na mundëson me krijue një kompleks sportiv, shesh dhe park për fshatin afër xhamisë. Edhe Komisioni mund të del në vendin e ngjarjes dhe të konstaton se cili është interes i qytetarëve tonë.

Dragan Dancetovic – ne sot në kontinuitet i kemi marrë disa vendime për formimin e disa Komisioneve për punën e Kuvendit. Unë thirrem në ligjin nr. 03-L-049 të MAPL-së, i cili është i bashkangjitur një Doracaku për trajnime të këshilltarëve komunal, ku Qeveria e Kosovës jepë të dhëna, që Komuna e Obiliqit i ka rrëth 26,000 banorë, nga kjo 3,360 banorë të komuniteteve pakicë. Këto janë të dhëna për nevoja të grandeve dhe kjo do të thotë se në Komunën tonë ka mbi 10 %, të komuniteteve pakicë. Nga Kuvendi komunal i Obiliqit kërkojmë që ti respektoj këto të dhëna nga Qeveria, dhe vendimet që i marrim në të adhmen të jenë në pajtim me këto të dhëna.

Pas diskutimeve, këshilltarët komunal me 14 vota “Për” 6 vota “Kundër” morën këtë:

V E N D I M

Për dhënien e Pëlqimit për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën private në zonën kadastrale në Bakshi.

Burim Gërguri – lexon kërkesën nga DKRS, për ndarjen e zyreve për OJQ-të, të cilat zhvillojnë aktivitet në Komunën tonë.

Pas propozimit të DKRS-së, këshilltarët komunal unanimisht morën këtë:

V E N D I M

Bëhet ndarja e zyrave për OJQ-të në objektin “Ndërtesa e bardhë” përballë sheshit “Aziz Zhilivoda” (ish zyrat e Drejtive: DSHMS, DKRS, DKA dhe DFEZH) dhe Shoqatat operuese në Komunën tonë sipas Komisionit për regjistrimin dhe vlerësimin e inventarit në objektin e Komunës së vjetër sipas propozimit të Drejtive DKRS dhe DAP.

Burim Gërguri - janë 3 kërkesa, të cilat në mbledhjen e KPF-së, ua kemi drejtue Drejtive përkatëse. Kërkesa e parë është nga Hasan Krasniqi, i cili kërkon një kod rrugor në Hamidi dhe DPUKP-ja, ka konstatuar se kjo kërkesë i plotëson kriteret dhe është në pajtim me Udhëzimin administrativ nr.12/2012, për caktimin e emërtimit dhe numërimit të adresave, për zona të qarkullimit publik ndërtesa, shtëpi, objekte dhe parcela kadastrale të lira.

Pas propozimit të DPUKP-së, këshilltarët komunal unanimisht morën këtë:

V E N D I M

Aprovohet kërkesa e banorëve të fshatit Hamidi për emërtimin e rrugës me emrin “Ali Gollaku” (Kod i ri).

Burim Gërguri – lexon kërkesën e dytë nga familja Raqi, në Mazgit për emërtim të rrugës. Edhe kjo kërkesë i plotëson kriteret dhe është në pajtim me Udhëzimin administrativ nr.12/2012.

Pas propozimit të DPUKP-së, këshilltarët komunal unanimisht morën këtë:

V E N D I M

Aprovohet kërkesa e banorëve të fshatit Mazgit për emërtimin e rrugës me emrin “Kadri Raqi” (Kod i ri).

Aziz Bici - gjatë shqyrtimit të kërkesës nga Drejtoria e urbanizmit, a ka pasë ndonjë ankesë prej banorëve të lagjes rrëth këtyre kërkesave.

Burim Gërguri – lexon kërkesën nga banorët e fshatit Kryshefc për emërtim të rrugës. Poashtu, edhe kjo kërkesë i plotëson kriteret dhe është në pajtim me Udhëzimin administrativ nr.12/2012.

Pas propozimit të DPUKP-së, këshilltarët komunal unanimisht morën këtë:

V E N D I M

Aprovohet kërkesa e banorëve të fshatit Kryshefc për emërtimin e rrugës me emrin “Shaban Shalaku” (Kod i ri).

Burim Gërguri – ju njoftoj se janë kthyer 3 vendime nga MAPL-ja, për rishikim dhe vendimet janë të ligjshme vetëm se duhet të plotësohen me emra. Te vendimi për formimin e Komisionit për vlerësimin e ofertave, për dhënien e pronës së paluajtshme janë 6 anëtarë, është dashur një propozim të jetë nga shoqëria civile. Ekzekutivi e ka sjellë propozimin me emrin Zelushe Kelmendi.

Shaip Paloja - unë e pashë edhe në procesverbal të seancës së kaluar këtë Komision, që është shumë me rëndësi për Komunën tonë, dhënia në shfrytëzim e tokave komunale, por këtu nuk është e përfshirë pjesa e opozitës. Unë e pranoj se ne atë ditë e kemi lëshuar seancën, por pavarësisht prej kësaj opozita duhet të jetë pjesë e Komisionit. Mendoj se e keni bërë një lëshim, që nuk është dashur me bë sepse ne e kemi lëshuar seancën, por kjo s'do të thotë se nuk do të jemi në Komision. Mendoj se neve, na takon një vend si opozitë.

Kryetari – e kam një sugjerim dhe unë e di se jeni në fillim të mandatit, keni pak mbledhje që keni mbajtë, por përcaktimi i rendit të ditës dhe pikat trajtohen sa është me rëndësi në mbledhje me qenë kuorumi dmth me qenë 11 anëtarë. Poashtu, nuk do të thotë se të gjitha votat pro e arsyetojnë këshilltarin, por prezencia, kontributi i tij në çdo diskutim e arsyeton votën që ai e ka marrë, qoftë pozitë apo opozitë. Tash, nuk e di Ministria, a pranon me ndërru sepse nëse ne kemi nxjerrë një vendim dhe Ministria kërkon plotësim edhe me një anëtar të shoqërisë civile dhe kjo duhet të kryhet. Pastaj, mundeni me rishikue edhe njëherë nëse ka nevojë me bë ndryshime, bëni ndryshime.

Shaip Paloja – Kryetar, unë e kuptoj se ndoshta ka pasë kuorum për me zgjedhë Komisione, por nuk do të thotë pse ne nuk jemi prezantë të anashkalohemi. Ne 2 ankesa, i kemi bërë në MAPL qe 2 muaj dhe asnjë përgjegje nuk e kemi marrë, që nuk e di pse nuk na përgjegjen së paku po, ose jo.

Kryetari – sa i përket vendimeve të Kuvendit, tash sipas ligjit i kërkojnë edhe vendimet e Kryetarit dhe Kuvendit komunal. Për çdo vendim në afat prej 14 ditësh, nëse nuk kthehet ndonjë përgjegje nga MAPL-ja, konsiderohet si i aprovuar. Edhe ata herë pas here, po pësojnë ndryshime dhe tash kanë filluar për çdo vendim me na dhënë përgjegje edhe kur është vendim pozitiv, që përparrë nuk e kanë bërë.

Aziz Bici – ne jemi në pritje se MAPL-ja, do të na kthen përgjegje ndaj kërkesës tonë që të kemi edhe ne së paku një anëtar në KPF. Edhe unë jam kundër këtij Komisioni që është zgjedhë dhe shpresoj se janë të vetëdijshëm se çfarë përgjegjësie kanë marrë sepse është përgjegjësi bukur e madhe dhënia në shfrytëzim e pronës komunale, se aty varet një e ardhme, një zhvillim i Komunës tonë. Nëse nuk e jepin kontributin si duhet mendoj se është përgjegjësi e madhe, parndaj duhet të jemi bashkëpunes dhe të kërkojmë ndihmën e njëri tjetrit.

Pas diskutimeve, këshilltarët komunal unanimisht morën këtë:

V E N D I M

Plotësohet Komisioni për vlerësimin e ofertave për dhënjen e pronës së Paluajtshme të Komunës në shfrytëzim me nr.I-24, të dt.28.02.2018 me këtë anëtarë:

Zelushë Kelmendi (shoqëria civile)

Kryetari – ne në mbledhjen e kaluar kemi marrë vendim për fillimin e negocimit për përgatitjen e memorandumit me Federatën, për dhënien e pronës në shfrytëzim. Meqë Federata e ka me nguti për shkak të donacionit me UEFA-në, ne kemi kërkuar interpretim nga MKRS-ja, dhe ata na kanë sqarue se kjo procedurë mund të zgjatë më shumë se 6 muaj. Edhe Ligji për dhënien e pronave në shfrytëzim pritet shumë shpejt të ndryshohet, por edhe ligji aktual mund të jetë rrezik për shkak të ofertuesve. Ne këtë informatë ia kemi dhënë Federatës dhe Federata e ka dorëzuar një shkresë që kjo procedurë të filloj përmes Ministrisë. Ne do t'ia ofrojmë Ministrisë pronën komunale për 25 vite, në shfrytëzim dhe

Ministria bashkë me neve, do të krijoj memorandumin dhe me Federatën. Pra, kjo tash plotësohet me pjesën e Ministrisë.

Pas propozimit të Kryetarit të Komunës, këshilltarët komunal unanimisht morën këtë:

V E N D I M

Me këtë vendim jepet në shfrytëzim kompleksi sportiv për Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, (MKRS) të parcelës nr.P-72614055-01459-13, në sipërfaqe prej 88299 m² dhe parcelës nr.P-72614055-01459-1 në sipërfaqe prej 14518 m², ZK- Obiliq në periudhën 25 vjeçare.

Kryetari – edhe për vendimin e zgjedhjes së Nënkyetarit për komunitete, pasi që MAPL-ja, brenda afatit nuk na ka dhënë përgjegje ne e kemi konsiderue si të plotfuqishëm, me dt.21.03, Ministria na e dërgon një njoftim për përsëritjen e votimit. Arsyja është se përveç shumicës së votave duhet të ketë edhe shumicën e votave të komuniteteve. Tani, kërkoj nga ju që të votohet përsëri për z.Slavisa Jakovljevic, Nënkyetar për komunitete.

Pas propozimit të Kryetarit të Komunës, këshilltarët komunal me 12 vota “Për” 6 vota “Kundër” (ndërsa, një këshilltarë nuk mori pjesë në votim) morën këtë:

V E N D I M

Emërohet z.Slavisa Jakovljevic, Nënkyetar i Komunës për Komunitete në Komunën e Obiliqit.

Burim Gërguri – kërkesa e fundit që na ka ardhë është për plotësim të KPF-së, me një emër të gjinisë femërore dhe këtë të drejtë e ka LDK-ja.

Shaip Paloja – ne në seancat e kaluara, ekziston edhe procesverbali megjithëse ne kemi këruar se na takojnë edhe më shumë anëtarë të Komiteteve obligative, është mbetë që na me i sjellë 2 emra të gjinisë femërore. Ju një anëtar tash, na e keni heqë krejtë prej Komitetit për komunitete dhe aty është emëruar z.Nazmi Gashi. Unë do të japë emrin se në KPF do të jetë Linda Sadiku, ndërsa në Komitetin për komunitete, Arbnora Mehana.

Burim Gërguri – tash është plotësimi vetëm për KPF, por nëse vjen ndonjë kërkesë për rishikim për Komitetin për komunitete, e kemi emrin Arbnora Mehana.

Shaip Paloja – kur është bërë rishikimi i vendimit, unë e kam propozuar Fatos Kurshumliun për KPF. Ju vet më keni thënë na i jepni 2 emra, të gjinisë femërore dhe unë nuk i kam dhënë, por tash po i japi, kështu ju po bjeni në kundërshtim me vetveten, pse nuk e di.

Pas diskutimeve, këshilltarët komunal me 16 vota “Për” 2 vota “Kundër” morën këtë:

V E N D I M

Plotësohet Komiteti për Politikë dhe Financa, sipas vendimit nr.I-29, të dt.28.02.2018 me këtë anëtarë:

Linda Sadiku (LDK)

Pika e 11 e rendit të ditës -

Ajet Berisha – ju njoftoj se në vitin 2007, Kuvendi komunal ka dhënë prona në shfrytëzim për 10 vjet dhe në kohën kur ju ka dalë afati i shfrytëzimit këtyre pronave, ka qenë koha e zgjedhjeve. Ne kemi qëlluar në periudhën 6 mujore, që sipas ligjit Kuvendi komunal nuk ka pasë të drejtë me i shqyrtau kërkuesat. Duke pasë për bazë këtë, ky Kuvend është obligativ me u marrë me këtë çështje. Sipas ligjit dhe Rregullores, Kryetari ia propozon Kuvendit për me inicu procedurën për shpallje, Komisioni merret me shpalljen e tyre dhe i trajton në mënyrën më meritore. Pastaj, ky Kuvend nga vlerësimi i atij Komisioni dhe Komisionit që i pranon vërejtjet vijnë me të gjitha dhe prapë ju keni me vendosë.

Aziz Bici – pa pasë ne diçka të shkruar për të vendosur në arkivat tona të shtëpisë, qysh s’ka kuptim përmua. Ju duhet të na i sjellni shkresat dhe të dijmë ne se çka po votojmë sepse kështu nuk ka kuptim të votojmë për diçka, ndërsa para vetes nuk kemi kurgjë.

Pas, diskutimeve, këshilltarët komunal unanimisht morën këtë:


V E N D I M

Paraprak për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës së Obiliqit në zonat kadastrale Obiliq-Miloshevë-Babimoc.

Dragan Dancetovic - unë kërkoj falje, por më duhet të them se për shkak të rishqyrtimit të vendimit të MAPL-së, për emërimin e Nënkyrytarit për komunitete, edhe më tutje jam kundër këtij emërimi.

Mbledhja përfundoi në ora 15:50'

Bashk. prof. për punë të KK



Azize Zeneli

Kryesuesi i Kuvendit komunal


Burim Gerguri

